

Dt. 05.03.2021

Akt Thmelimi

I shoqërisë tregtare “” sh.p.k

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr.7512 datë 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit”, të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 , “ Për shoqëritë tregtare” dhe të ligjit Nr.9723 , datë 03.05.2007 “Për Q.K.R dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqërite Tregtare, me vullnetin e tij të lirë, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi ne ortaket: individ me përgjegjësi të kufizuar, banues në Maminas, krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “RUDI CONSTRUCTION” sh.p.k me akt themelimi si vijon:

Formulimi

Neni 1

Sot me date 05.03.2021, formohet shoqëria tregtare private e quajtur “RUDI CONSTRUCTION” sh.p.k . Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit Shqipëtar, ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtroje veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaket themelues.

Selia e Shoqërisë

Neni 2

Selia e shoqërisë tregtare privatë, Durrës, Maminas, Fshati Karpen, Rruga Shilore, Lagjia Vlashke, Objekt me nr.27. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të ortakëve.

Objektivi I Veprimtarisë

Neni 3

Veprimtari tregtare Ndertim, punime te objekteve te ndryshme, ndërtim shtëpi druri, mobileri, elektrike, hidraulike, termoizolim, ndërtim rruge dhe kanalizime, Rikonstruksion dhe ndërtim ujësjellësi, ujëra të bardha dhe të zeza, ndërtim linje tension të lart dhe të ulët, Rikonstruksione objekte publike dhe jo publike, Përgatitja e dokumentacioit për marrjen e aktit teknik. Trajnime e dhënie te asistences në fushën e mbrojtjes nga zjarri. Transport të mbetjeve Jo të Rrezikshme. Punime infrastrukture në zonat e mbrojtura. Punime për rehabilitimin e skemave ujitëse dhe kanaleve kullues. Mirëmbajtje rrugore (Rutine dhe dimërore).

Kohëzgjatja e Shoqerise

Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të përcaktuar . Ajo mund shpërbëhet në cdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak .

Kapitali I Shoqerise

Neni 5

Kapitali fillestar I shoqerise private "RUDI CONSTRUCTION " sh.p.k do te jetë 100.000 (një qind mijë lekë). Kapitali eshte 100% nga kuotat e ortakëve do jenë 100% Rudin Dika, e ndarë në 1 kuotë. Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet ose të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar).

Drejtimi I Shoqerise

Neni 6

Shoqëria do të drejtohet nga administratori I saj, ortaku I vetëm dhe përfaqësuesi ligjor I saj. Ai është përfaqësuesi I Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj. Cdo kontrate do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues I pajisur me prokure të posacme.

Neni 7

Të ardhurat neto të shoqërisë I takojnë ortakut të vetëm.

Neni 8

Ortaku I vetëm themelues ka të drejt të emëroje dhe administratore të tjere të vlerave materiale, Ka të drejt të caktoj financiere, likuidator për problemet e shoqërisë si dhe të pajtoje persona te tjere si ortake.

Neni 9

Konfliktet që mund të lindin do te zgjidhën në zbatim te legjislacionit Shqipëtar ne Gjykatën e Rethit Gjyqësor Durrës.

Neni 10

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi te zakonshme, me tekstin rreth saj.

Neni 11

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plot të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Për Krijimin e Shoqërive Tregtare”, si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri.

Neni 12

Akti I themelimit u perpilua ne 2 kopje, per t'ju shpërndare organeve kompetente dhe një kopje do te mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “RUDI CONSTRUCTION” sh.p.k.

Akti I themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët.

Ortakët themelues të sh.p.k

Rudin DIKA

